

VENDIM
Nr.763, datë 27.11.2006

PËR KOMPENSIMIN E TË ARDHURAVE MUJORE TË PENSIONISTËVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kompensimin, deri në 760 (shtatëqind e gjashtëdhjetë) lekë, të të ardhurave mujore të pensionistëve, që marrin pensione pleqërie, pensione invaliditeti dhe pensione familjare, të caktuara në përputhje me dispozitat e ligjit nr.4171, datë 13.9.1966 “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë” dhe të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me përjashtim të pensioneve të caktuara, në përputhje me dispozitat e ligjit nr.4976, datë 29.6.1972 “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, dhe të pensioneve të caktuara, në përputhje me paragrafin e katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, që në datë 30.11.2006 janë deri në 10 000 (dhjetë mijë) lekë.

2. Në kuptim të këtij vendimi, të ardhurat mujore të pensionistit, përfshijnë masën e pensionit të pleqërisë, kompensimin, që jepet sipas vendimeve nr.138, datë 31.3.1994 të Këshillit të Ministrave “Për kompensimin e shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse”, nr.471, datë 15.7.1996 të Këshillit të Ministrave “Për kompensimin nga ndryshimi i çmimit të bukës, vajgurit dhe gazit të lëngshëm” dhe nr.401, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve”.

3. Kompensimi i të ardhurave mujore të pensionistit, deri në kufirin e pikës 1 të këtij vendimi, të bëhet, si më poshtë vijon:

a) Pensionistëve, që marrin pensione të plota pleqërie, të cilët para datës 1.12.2006 kanë të ardhura mujore nga 9 240 (nëntë mijë e dyqind e dyzet) lekë deri në 10 000 (dhjetë mijë) lekë, t’u shtohet shuma deri në 760 (shtatëqind e gjashtëdhjetë) lekë në muaj dhe, pas kësaj, shuma e të ardhurave mujore arrijnë 10 000 (dhjetë mijë) lekë.

b) Pensionistëve, që marrin pensione të pjesshme pleqërie, të cilët para datës 1.12.2006 kanë të ardhura mujore nën 9 240 (nëntë mijë e dyqind e dyzet) lekë, t’u shtohet shuma deri në 760 (shtatëqind e gjashtëdhjetë) lekë në muaj.

Masa individuale e kompensimit llogaritet, duke shumëzuar masën e plotë të kompensimit me masën e pensionit mujor, pjesëtuar me masën e pensionit minimal.

c) Pensionistëve, që marrin pensione të plota invaliditeti dhe pensione të plota familjare, të cilët para datës 1.12.2006 kanë të ardhura mujore nga 8 740 (tetë mijë e shtatëqind e dyzet) lekë deri në 9 500 (nëntë mijë e pesëqind) lekë, t’u shtohet shuma deri në 760 (shtatëqind e gjashtëdhjetë) lekë në muaj.

ç) Pensionistëve, që marrin pensione të pjesshme invaliditeti dhe pensione të pjesshme familjare, të cilët para datës 1.12.2006 kanë të ardhura mujore nën 8 740 (tetë mijë e shtatëqind e dyzet) lekë, t’u shtohet shuma deri në 760 (shtatëqind e gjashtëdhjetë) lekë në muaj.

Masa individuale e kompensimit llogaritet, duke shumëzuar masën e plotë të kompensimit me masën e pensionit mujor, pjesëtuar me masën e pensionit minimal.

4. Kompensimin shtesë për të ardhurat mujore, të përcaktuar në shkronjat “a”, “b”, “c” e “ç” të pikës 3 të këtij vendimi, e marrin edhe pensionistët, që datën e fillimit të pensionit e kanë nga data 1.12.2006 e në vazhdim, përfshirë dhe këtë datë.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2006, në shumën 154 766 000 (njëqind e pesëdhjetë e katër milionë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i sigurimeve shoqërore për vitin 2006.

6. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare sh.a. për zbatimin e këtij

vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.12.2006.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha